Tabela e përputhshmërisë

1. Direktiva 2011/64/EC e datës 21 Qershor 2011 "Mbi strukturën dhe normat e akcizës që aplikohen për duhanin e përpunuar". • Celex nr. 32011L0064; • Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian Seria L, Nr. 176, 5 Korrik 2011, faqe 24-36; ***Shënuar tek kolona e referencës me numër 1.***		Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 61/2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar"". Përputhshmëri e plotë				
1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Teksti	Përputhshmëria	Shënime
(7)	(7) Prodhuesi duhet të përkufizohet si një person fizik ose juridik që në mënyrë efektive përgatit produktet e duhanit dhe përcakton çmimin maksimal të shitjes me pakicë për secilin nga Shtetet Anëtare në të cilat produktet në fjalë do të hidhen në konsum.	1	2	Në nenin 78 "Përkufizime", pas pikës 7, shtohet pika 8 me përmbajtje si më poshtë: "8. "Prodhues i produkteve të duhanit" është një person fizik ose juridik që prodhon produkte duhani dhe përcakton çmimin maksimal të shitjes me pakicë.".	E plotë	Është propozuar, që në nenin 78 "Përkufizime", të shtohet edhe përkufizimi *"Prodhues i produkteve të duhanit".* Ky përkufizim vjen në kuadër të përafrimit të plotë pikën (7) të Direktivës 2011/64/BE, si dhe krijon bazën ligjore për zbatimin e sistemit të akcizës së përzier mbi cigaret, në përputhje me kërkesat e kësaj direktive.

Pikat (1) dhe (2), të nenit 7 Pikat (1) dhe (2), të nenit 8	Neni 7 1. Cigaret e prodhuara në Bashkim dhe ato të importuara nga vendet e treta i nënshtrohen një akcize ad valorem, e llogaritur mbi çmimin maksimal të shitjes me pakicë, duke përfshirë detyrimet doganore, si dhe një akcize specifike të llogaritur për njësi të produktit. Pavarësisht nënparagrafit të parë, Shtetet Anëtare mund të përjashtojnë detyrimet doganore nga baza për llogaritjen e akcizës ad valorem mbi cigaret. 2. Norma e akcizës ad valorem dhe shuma e akcizës specifike duhet të jenë të njëjta për të gjitha cigaret. ….”. Neni 8 “1. Përqindja e komponentit specifik të akcizës në shumën e barrës totale tatimore mbi cigaret përcaktohet duke iu referuar çmimit mesatar të ponderuar të shitjes me pakicë. 2. Çmimi mesatar i ponderuar i shitjes me pakicë llogaritet duke iu referuar vlerës totale të të	1	79	Në nenin 79 “Detyrimet”, bëhen ndryshimet si më poshtë: 1. Pika 1, ndryshohet si më poshtë: “*1. Baza për llogaritjen e akcizës për cigaret është 1000 copë/fije dhe çmimi maksimal i shitjes me pakicë, ndërsa për purot dhe cigarillot është kg.*”. 2. Pas pikës 2, shtohen pikat 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8, me përmbajtje si më poshtë: “*3. Akciza për cigaret përbëhet nga një komponent specifik, i përcaktuar në një shumë të caktuar për një sasi prej 1000 copë/fije dhe nga 1 Janari 2030 edhe nga një komponent proporcional (ad valorem), i llogaritur si përqindje e çmimit maksimal të shitjes me pakicë të cigareve.* *4. Çmimi maksimal i shitjes me pakicë i cigareve të hedhura për konsum në territorin e Republikës së Shqipërisë është çmimi i vendosur për çdo markë të cigareve nga prodhuesit dhe importuesit, i cili përfshin akcizën, taksën doganore dhe tatimin mbi vlerën e shtuar.* *5. Prodhuesit dhe importuesit duhet të deklarojnë çmimin maksimal të shitjes me pakicë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave jo më*	E plotë	Është propozuar, që të bëhen ndryshime në nenin 79 “Detyrimet”, me qëllim zgjerimin objektin e këtij neni, duke krijuar bazën ligjore për kalimin gradual nga sistemi aktual i akcizës plotësisht specifike drejt një sistemi të përzier të akcizës për cigaret, në përputhje me kërkesat e Direktivës 2011/64/BE.

	gjitha cigareve të hedhura në konsum, bazuar në çmimin e shitjes me pakicë duke përfshirë të gjitha taksat, të pjesëtuar me sasinë totale të cigareve të hedhura në konsum. Ai përcaktohet jo më vonë se data 1 mars e çdo viti, në bazë të të dhënave që lidhen me të gjitha hedhjet e tilla në konsum të kryera gjatë vitit kalendarik pararendës…”.			*vonë se 10 ditë përpara hedhjes për konsum të cigareve. Cigaret nuk mund të shiten me çmim të shitjes me pakicë më të lartë se çmimi maksimal i deklaruar.*		
Neni 9	Neni 9 1. Shtetet Anëtare zbatojnë mbi cigaret taksa minimale të konsumit në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë kapitull. 2. Paragrafi 1 zbatohet për taksat që, sipas këtij kapitulli, vendosen mbi cigaret dhe që përfshijnë: (a) një akcizë specifike për njësi produkti; (b) një akcizë ad valorem të llogaritur mbi bazën e çmimit maksimal të shitjes me pakicë; (c) një TVSH proporcionale me çmimin e shitjes me pakicë.			*6. Nga 1 Janari 2030, akciza totale (akciza specifike dhe proporcionale (ad valorem) duke përjashtuar tatimin mbi vlerën e shtuar) për cigaret nuk do të jetë më e ulët se vlera ekuivalente në lekë e shumës 90 euro për 1,000 copë/fije. Nga 1 Janari 2033, totali i akcizës (akciza specifike dhe proporcionale (ad valorem) duke përjashtuar tatimin mbi vlerën e shtuar) për cigaret duhet të jetë të paktën 60% e çmimit mesatar të ponderuar të shitjes me pakicë të cigareve të hedhura për konsum dhe në çdo rast jo më pak se vlera ekuivalente në lekë e shumës 90 euro për 1,000 copë/fije, pavarësisht nga çmimi mesatar i ponderuar i shitjes me pakicë të cigareve të hedhura për konsum.* *7. Çmimi mesatar i ponderuar i shitjes me pakicë përcaktohet jo më vonë se data 1 Mars e çdo viti dhe llogaritet duke marrë në konsideratë vlerën totale të të gjitha cigareve të hedhura për konsum gjatë vitit kalendarik të mëparshëm, bazuar në çmimin e shitjes me pakicë që përfshin të gjitha taksat,*		

Pika (2) e nenit 10	Neni 10 "… *2. Nga 1 janari 2014, akciza totale mbi cigaret duhet të përfaqësojë të paktën 60 % të çmimit mesatar të ponderuar të shitjes me pakicë të cigareve të hedhura në konsum. Kjo akcizë nuk duhet të jetë më e ulët se 90 EUR për 1 000 cigare, pavarësisht çmimit mesatar të ponderuar të shitjes me pakicë.* *Megjithatë, Shtetet Anëtare që vendosin një akcizë prej të paktën 115 EUR për 1 000 cigare mbi bazën e çmimit mesatar të ponderuar të shitjes me pakicë nuk kanë nevojë të respektojnë kërkesën prej 60 % të përcaktuar në nënparagrafin e parë.* *...".*			*pjesëtuar me sasinë totale të cigareve të hedhura për konsum gjatë asaj periudhe.* *8. Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen procedurat për zbatimin e këtij neni.*".		
Pika (1) e nenit 15	Neni 15 1. Prodhuesit ose, sipas rastit, përfaqësuesit e tyre apo agjentët e autorizuar në Bashkim, si dhe importuesit e duhanit nga vendet e treta, janë të lirë të përcaktojnë çmimin maksimal të shitjes me pakicë për secilin prej					

	produkteve të tyre në secilin Shtet Anëtar në të cilin produktet në fjalë do të hidhen në konsum. Megjithatë, nënparagrafi i parë nuk mund të pengojë zbatimin e sistemeve kombëtare të legjislacionit në lidhje me kontrollin e niveleve të çmimeve ose respektimin e çmimeve të imponuara, me kusht që ato të jenë në përputhje me legjislacionin e Bashkimit.					
Direktiva 2011/64/EC Pika 2, neni 10	Neni 10 "…. 2. Duke filluar nga 1 janari 2014, akciza totale mbi cigaret duhet të përfaqësojë të paktën 60% të çmimit mesatar të ponderuar të shitjes me pakicë të cigareve të hedhura për konsum. Kjo akcizë nuk duhet të jetë më e ulët se 90 euro për 1 000 cigare, pavarësisht nga çmimi mesatar i ponderuar i shitjes me pakicë. ..."	1	Shtojca nr. 1, Kategoria III, Duhani dhe nënproduktet e tij.	T200 Cigare që përmbajnë duhan 24 02 20 8,100 lekë/1000 fije më 1 Janar, 2027 8,450 lekë/1000 fije më 1 Janar, 2028 8,800 lekë/1000 fije më 1 Janar, 2029 2% të çmimit të shitjes me pakicë + 9,150 lekë/1000 fije më 1 Janar, 2030 3% të çmimit të shitjes me pakicë + 9,150 lekë/1000 fije më 1 Janar, 2031 4% të çmimit të shitjes me pakicë + 9,150 lekë/1000 fije më 1 Janar, 2032	E plotë	Në këtë projektligj është riskeduluar akciza për cigaret, duke propozuar një rritjeje të akcizës së cigareve me rreth 350 lekë në vit nga viti 2027 deri në vitin 2030, së bashku me aplikimin e komponentit ad valorem, duke filluar me 2% në vitin 2030 dhe duke u rritur me 1% çdo vit deri në vitin 2033. Ky propozim është në përputhje të plotë me pikën 2, të nenit 10, të Direktivës së Këshillit 2011/64 BE.

				5% të çmimit të shitjes me pakicë + 9,150 lekë/1000 fije më 1 Janar, 2033.		
Direktiva 2011/64/EC Paragrafi 4, pika 2, neni 14	Neni 14 2. Akciza totale (akciza specifike dhe/ose akciza ad valorem, pa përfshirë TVSH-në), e shprehur si përqindje, si shumë për kilogram ose për një numër të caktuar copësh, duhet të jetë të paktën e barabartë me normat ose shumat minimale të përcaktuara për: ... *Nga 1 janari 2020, akciza totale mbi duhanin e prerë imët për pirje, i destinuar për mbështjelljen e cigareve, duhet të përfaqësojë të paktën 50% të çmimit mesatar të ponderuar të shitjes me pakicë të duhanit të prerë imët për pirje, i destinuar për mbështjelljen e cigareve të hedhura në konsum, ose të paktën 60 euro për kilogram.* ...".	1	Shtojca nr. 1, Kategoria III, Duhani dhe nënproduktet e tij	T400 Duhan tjetër i përpunuar dhe zëvendësuesit e duhanit 24 03 Duhan tjetër i përpunuar dhe zëvendësuesit, duhan me dredhje (lekë/kg) 8,100 lekë/kg më 1 Janar, 2027 8,450 lekë/kg më 1 Janar, 2028 8,800 lekë/kg më 1 Janar, 2029 9,150 lekë/kg më 1 Janar, 2030 9,500 lekë/kg më 1 Janar, 2031 9,850 lekë/kg më 1 Janar, 2032 10,200 lekë/kg më 1 Janar, 2033. Duhan i përpunuar me gjethe duhani të kultivuara në Shqipëri (lekë/kg) 4,100 lekë/kg më 1 Janar, 2027 5,783 lekë/kg më 1 Janar, 2028 7,467 lekë/kg më 1 Janar, 2029 9,150 lekë/kg më 1 Janar, 2030 9,500 lekë/kg më 1 Janar, 2031 9,850 lekë/kg më 1 Janar, 2032 10,200 lekë/kg më 1 Janar, 2033.	E plotë	Në këtë projektligj është riskeduluar akciza për kategorin T400 "Duhan tjetër i përpunuar dhe zëvendësuesit e duhanit", duke propozuar një kalendar rritje për vitet 2027-2033 dhe është plotësisht në përputhje me paragrafin 4, të pikës 2, nenit 14, të direktivës. Gjithashtu përmes këtij projekligji është propozuar eleminimi i diferencimit midis duhanit të përpunuar nga importi dhe atij të përpunuar me gjethe duhani të kultivuara në Shqipëri, ku në vitin 2029, tarifat e këtyre dy produkteve barazohen me njëra-tjetrën.

Direktiva 2011/64/EC Shkronja (c), pika 2, neni 14	Neni 14, "... 2. Akciza totale (akciza specifike dhe/ose akciza proporcionale, pa përfshirë TVSH-në), e shprehur si përqindje, si shumë për kilogram ose për një numër të caktuar njësish, duhet të jetë të paktën e barasvlershme me normat ose shumat minimale të përcaktuara për: ... (c) duhanin tjetër për tymosje: 20 % e çmimit të shitjes me pakicë, të përfshirë të gjitha taksat, ose 22 euro për kilogram. ...".		Shtojca nr. 1, Kategoria III, Duhani dhe nënprodu ktet e tij	T403 Shisha, nargjile 24 03 11 Shisha, nargjile (përzierje për tymosje) (lekë/kg duhan në produkt) 2,213 lekë/kg 1 Janar, 2027 2,238 lekë/kg 1 Janar, 2028 2,263 lekë/kg 1 Janar, 2029 2,288 lekë/kg 1 Janar, 2030 2,313 lekë/kg 1 Janar, 2031 2,338 lekë/kg 1 Janar, 2032 2,363 lekë/kg 1 Janar, 2033 Shisha, nargjile (përzierje për tymosje) përpunuar me gjethe duhani të kultivuara në Shqipëri (lekë/kg duhan në produkt) 1,438 lekë/kg 1 Janar, 2027 1,938 lekë/kg 1 Janar, 2028 2,263 lekë/kg 1 Janar, 2029 2,288 lekë/kg 1 Janar, 2030 2,313 lekë/kg 1 Janar, 2031 2,338 lekë/kg 1 Janar, 2032 2,363 lekë/kg 1 Janar, 2033	E plotë	Në këtë projektligj është riskeduluar akciza për kategorin T403 Shisha, nargjile, duke propozuar një kalendar rritje për vitet 2027-2033 dhe është plotësisht në përputhje me shkronjën c), të pikës 2, të nenit 14, të direktivës. Gjithashtu përmes këtij projekligji është propozuar eleminimi i diferencimit midis Shisha, nargjile (përzierje për tymosje) nga importi dhe Shisha, nargjile (përzierje për tymosje) të përpunuar me gjethe duhani të kultivuara në Shqipëri, ku në vitin 2029, tarifat e këtyre dy produkteve barazohen me njëra-tjetrën.